



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:027533

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875049

KPPP.nr.156/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komuna e Junikut, me seli në Junik, kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Mbretëresha Teutë”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.1130/18 të datës 12.12.2018, të Përmbaruesit Privat Zija Bala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS SH.A., ANULOHET urdhri Përmbarimor P.nr.1130/18 i datës 12.12.2018, i Përmbaruesit Privat Zija Bala, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Junikut, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.1130/18 të datës 12.12.2018, me të cilin ka lejuar përmbarimin mbi bazën e dokumentit përmbarimor, Aktvendimit 04 Nr.23, të datës 29.10.2018, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 300.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë ashtu që përmbaruesi dhe detyrimin të bëhet edhe me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe

shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se urdhri përmbartimor është marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 71 të LPP-së, ngase dokumenti i besueshëm nuk është në origjinal apo kopje të vërtetuar dhe e ngarkon debitorin në mënyrë paushallë për kinse borxhin e pa paguar për vitin 2018. Tutje ka shtuar se kërkesa e kreditorit është e parashkruar ngase ka kaluar afati për ta kërkuar borxhin sipas kërkesës së kreditorit. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta refuzoj si të pabazuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa, sipas nenit 24.3 të LPP-së, *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër me nenin 27.1 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative elementet të cilat duhet ti përmbaj dokumenti përmbartimor për të shërbyer si dokument i përshtatshëm për përmbartim, ku sipas kësaj dispozite *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cituara si më lartë dhe bazuar në shkresa të lëndës, gjen se Aktvendimi 04 Nr.23, i datës 29.10.2018, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3 dhe nenin 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Ndërsa, në pjesën e fundit të dispozitivit të këtij aktvendimit, pasojë e mos përmbushjes është përcaktuar se do të merren masa administrative për mbylljen e firmës, dhe jo detyrimi për ekzekutim të dhunshëm të lartësisë së takës së caktuar për ushtrimin e veprimtarisë.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk përmban dokument përmbarimor ngase nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si i tillë nuk mund të shërbej si dokument për të iniciuar procedurën përmbarimore, nuk u lëshuar në trajtimin e prapësimeve materiale të paraqitura nga debitori në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13, par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.156/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.